



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.157

22 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1021, datë 14.10.2009	Për miratimin e planit të veprimit të përditësuar të strategjisë kombëtare “Menaxhimi i integruar i kufirit”	7015
Vendim i KM nr.1022, datë 14.10.2009	Për një shtesë në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar	7046

VENDIM
Nr.1021, datë 14.10.2009

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË PËRDITËSUAR TË STRATEGJISË
KOMBËTARE “MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të përditësuar të strategjisë kombëtare “Menaxhimi i integruar i kufirit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I VEPRIMIT PËR MIK (I PËRDITËSUAR)
POLICIA KUFITARE DHE E MIGRACIONIT - BASHKËPUNIMI BRENDË SHËRBIMIT
Kuadri ligjor rregullator
Menaxhimi dhe organizimi
OBJEKTIVI 1/1 Përsosja e strukturës për trajtimin e shtetasve që kthehen nga policitë e vendeve të tjera nga PKM, bazuar në standardet dhe të drejtat e njeriut.
TREGUESIT Vënia në zbatim e strukturës së re të shoqërohet me profilizimin e personelit që do të merret me intervistimin e shtetasve të kthyer.
SITUATA AKTUAL: Aktualisht PKM bën intervistimin e shtetasve që kthehen nga policitë e vendeve të tjera. Në pjesën më të madhe të stacioneve kushtet e pritjes së tyre nuk janë në parametrat e duhur. Intervistimi i shtetasve kryhet nga punonjës të Policisë Kufitare dhe Migracionit të trajnuar për këtë proces dhe njohës të sistemit TIMS. Nuk ka personel të mjaftueshëm. Ngarkesa e një intervistuesi është shumë më e madhe se norma e lejuar.
KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA PKM duhet të jetë e specializuar, e unifikuar, e mirëtrajnuar dhe profesionale. Përveç kësaj duhet të krijohen kushtet më të mira për kryerjen me sukses të detyrës.
VEPRIMET E PROPOZUARA 1. Të bëhet një studim për ngarkesën e stacioneve të PKM-së në drejtim të intervistimit të shtetasve që kthehen nga vendet e tjera. 2. Të profilizohet personeli që do të merret me intervistimin e shtetasve që kthehen.
PALET E INTERESUARA Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH.
VEPRIMI 1 Të bëhet një studim për ngarkesën e stacioneve të PKM në drejtim të intervistimit të shtetasve që kthehen nga vendet e tjera.
VEPRIMTARIA 1. Analizimi i nevojave sipas stacioneve dhe numrit të shtetasve që kthehen dhe intervistohen. 2. Të matet ngarkesa e punës e intervistuesve.

3. Të bëhen propozimet për kompletimin e stacioneve që kanë më shumë kthime.
PËRPARËSI KRYESORE
REZULTATI I PRITSHËM Kompletimi i stacioneve me personel për intervistimin e shtetasve që kthehen.
TREGUESIT Intervistime më të plota dhe profesionale. Identifikim më i mirë i viktimave të trafikimit.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM Kostot: Kosto administrative Përfitimet: Krijimi i një personeli të profilizuar në intervistimin e shtetasve që kthehen.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Qershor 2009
LIDHJE Objektivi 1/1, veprimi 2
VEPRIMI 2 Të profilizohet personeli që do të merret me intervistimin e shtetasve që kthehen.
VEPRIMTARIA 1. Evidentimi i personelit që do të punojë me intervistimet. 2. Përzgjedhja dhe certifikimi i tyre.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Kompletimi i stacioneve me personel për intervistimin e shtetasve që kthehen.
TREGUESIT Intervistime më të plota dhe profesionale. Identifikim më i mirë i viktimave të trafikimit.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË MB, PSHSH/PKM.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM Kostot: Kosto administrative Përfitimet: Krijimi i një personeli të profilizuar në intervistimin e shtetasve që kthehen.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Qershor 2009
LIDHJE Objektivi 1/1, veprimi 1
OBJEKTIVI 2/1 Të sigurohet zhvillimi dhe vënia në zbatim e masave antikorruption në kuadrin e PKM.
TREGUESIT Zbatimi i masave antikorruption.
SITUATA AKTUALE Aktualisht personeli i Policisë Kufitare dhe Migracionit ka marrë disa masa ndaj fenomenit të korrupsionit në kuadrin e masave të marra nga Policia e Shtetit. Ekziston një strategji kombëtare antikorruption. Ekziston edhe kuadri ligjor i përshtatshëm për luftën ndaj korrupsionit. PKM është e detyruar me ligj të luftojë korrupsionin.

KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Drejtuesit e PKM duhet të krijojnë kushtet për të luftuar korrupsionin në përputhje me legjislacionin, strategjinë dhe praktikat më të mira.
VEPRIMET E PROPOZUARA 1. Të hartohet një “Kod etike” dhe “Kod sjelljeje” për oficerët e Policisë Kufitare dhe Migracionit. 2. Të realizojmë një “Vlerësim të riskut” për të identifikuar fushat e prekshme. 3. Të bëhet njohja me “Protokollet rigoroze për verifikimin e personalitetit” për personelin e ri. 4. Të organizohen trajnime për mbikëqyrësit e Policisë së Kufirit & Migracionit dhe “Mbi etikën” për Policinë e Shtetit. 5. Të ngrihet një linjë konfidenciale për raportime pranë SHKB-së dhe sektorit të ankesave dhe disiplinës si për personelin e K&M, edhe për publikun. 6. Të bëhet prezantimi i masave për sigurimin e të dhënave. 7. Të bëhet fushatë për “Sensibilizimin e publikut”. 8. Të bëhet njohja me procesin për menaxhimin e performancës. 9. Të bëhet njohja me “Testin e integritetit”. 10. Të bëhen kontrolle të forta administrative. 11. Të bëhet njohja me aktet normative për luftën kundër sjelljeve jo etike. 12. Të krijohet grupi strategjik për “Standardet jo etike”. 13. Të instalohen kamera dhe pajisje teknike në kabinat e pikave të kalimit të kufirit për monitorimin e aktivitetit të lidhen me monitorët në sallën operative në Drejtorinë e Përgjithshme. 14. Të minimizohen transaksionet e ligjshme financiare në PKK për të reduktuar në këtë mënyrë mundësinë për aktivitete të korruptuar. Të bëhet analiza e aktivitetit të sistemit TIMS.
PALËT E INTERESUARA Njësia antikorrupsion pranë Këshillit të Ministrave, MB, PSHSH/PKM, SHKB, sektori privat, publiku, media, organet e drejtësisë.
VEPRIMI 1 Të hartohet një “Kod etike” dhe “Kod sjelljeje” për oficerët e Policisë së Kufirit dhe Migracionit.
VEPRIMTARIA - Të ngrihet grupi i punës për Kodin e Etikës dhe të Sjelljes. - Përfundim i Rregullores së Disiplinës së Policisë. - Përgatitja e projektit. - Miratimi i Kodit të Etikës dhe të Sjelljes. - T’i shpërndahen çdo oficeri.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Përfundim pritshmërie. Minimizim i rasteve korruptive.
TREGUESIT Mbështetje me mbikëqyrje dhe ndërhyrje për përfundim në drejtim të strukturave të PKM.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH-në.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM Kostot: Me fonde të PAMECA-s Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15,16

VEPRIMI 2 Të realizojmë një “vlerësim të riskut” për të identifikuar fushat e prekshme.
VEPRIMTARIA - Të identifikojmë fushat potenciale ku mund të zhvillohet korrupsion së bashku me PAMECA III. - Të reduktojmë mundësinë e përfshirjes në aktivitete korrupsioni
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Fushat potenciale të korrupsionit të punonjësve të policisë të evidentuara.
TREGUESIT Mbështetje me mbikëqyrje dhe ndërhyrje për përfundim në drejtim të strukturave të PKM-së.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM Kostot: Me fonde të PAMECA-s Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 3 Të bëhet njohja me “Protokollet rigoroze për verifikimin e personalitetit” për personelin e ri.
VEPRIMTARIA Do të punojmë me Drejtorinë e Personelit dhe ekspertin e burimeve njerëzore pranë PAMECA III për deklaratën e pasurisë.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Deklarata e pasurisë e hartuar dhe e pranuar.
TREGUESIT Sigurohet transparenca e punonjësve të PKM-së.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM Kostot: Me fonde të PAMECA-s Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2, veprimet 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 4 Të organizohen trajnime për mbikëqyrësit e Policisë së Kufirit & Migracionit dhe “Mbi etikën” për Policinë e Shtetit.

VEPRIMTARIA 1. Hartimi i programit. 2. Përgatitja e kurrikulës. 3. Përgatitja e trajnimit. 4. Miratimi i programit dhe kurrikulës. 5. Zhvillimi i trajnimit.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Mbikëqyrësit të trajnuar për evidentimin e rasteve korruptive.
TREGUESIT Mbikëqyrje rigorozë. Monitorim i vazhdueshëm. Menaxhim efektiv i personelit.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 5 Të ngrihet një linjë konfidenciale për raportime pranë SHKB-së dhe sektorit të ankesave dhe disiplinës si për personelin e K&M, edhe për publikun.
VEPRIMTARIA 1. Të evidentohet linja konfidenciale, së bashku me SHKB dhe sektorin e analizave dhe disiplinës. 2. Të vendoset nr. telefonit.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Sistemi i SHKB-së tashmë i ngritur. Duhet punuar për të njëjtën gjë lidhur me Departamentin e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit Vendosja e një numri telefoni për ankesat dhe denoncimet e shtetasve.
TREGUESIT Shtetasit kanë ku të denoncojnë rastet e ndodhura.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16

VEPRIMI 6 Të bëhet prezantimi i masave për sigurimin e të dhënave.
VEPRIMTARIA 1. Të bëhet menaxhimi i të dhënave konfidenciale. 2. Të parandalohet rrjedhja e informacionit.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Menaxhimi i të dhënave konfidenciale bëhet me profesionalizëm. Informacioni merret dhe ruhet.
TREGUESIT Shtetasit kanë siguri për denoncimet e tyre.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 7 Të bëhet fushatë për “Sensibilizimin e publikut”
VEPRIMTARIA 1. Të bëhet prezantimi i Kodit të Etikës “Si të ankohe mi”. 2. Të informohet për pritshmërinë e publikut në pikat e kalimit kufitar.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Kodi i etikës i prezantuar. Publiku i informuar.
TREGUESIT Shtetasit kanë siguri dhe informacion se si do t’i bëjnë denoncimet e tyre.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Tetor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 8 Të bëhet njohja me procesin për menaxhimin e performancës.
VEPRIMTARIA

Lidhet me mbikëqyrjen rigoroze (veprimi 4, më sipër)
VEPRIMI 9 Të bëhet njohja me “testin e integritetit”
VEPRIMTARIA 1. Të përgatitet testi i integritetit. 2. Të miratohet testi i integritetit. 3. Të bëhet testi i integritetit në bashkëpunim me SHKB.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Testi i përgatitur dhe i zhvilluar.
TREGUESIT Punonjësit e PKM-së kalojnë testin e integritetit.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Nëntor 2009
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 10 Të bëhen kontrole të forta administrative.
VEPRIMTARIA 1. Të organizohen inspektime të rregullta pranë strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit. 2. Të inspektohen respektimi i procedurave standarde të punës dhe protokolleve të administrimit të brendshëm. 3. Të përgatiten konkluzionet.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Inspektim i rregullt i Drejtorisë së Kufirit & Migracionit nga sektori i standardeve profesionale në Drejtorinë e Standardeve Profesionale në bashkëpunim me ekspertin afatgjatë të PAMECA-s për standardet profesionale.
TREGUESIT Transparenca në inspektime dhe konkluzionet janë realiste.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Janar 2010

LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16
VEPRIMI 11 Të bëhet njohja me aktet normative për luftën kundër sjelljeve jo etike.
VEPRIMTARIA 1. Të bëhet grumbullimi i akteve normative. 2. Të bëhet ballafaqimi me rastet e evidentuara. 3. Të punohet me aktet normative.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Evidentimi i rasteve të shoqërisë së papërshtatshme. Pasojat që vijnë nga dhuratat dhe bakshishet janë të qarta.
TREGUESIT Personeli nje pasojat e shoqërisë së papërshtatshme.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III Kostot: Me fonde të PAMECA-s Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Janar 2010
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15,16
VEPRIMI 12 Të krijohet grupi strategjik për “Standardet jo etike”.
VEPRIMTARIA 1. Të evidentohen personat që do të bëjnë pjesë në grup. 2. Të përgatitet urdhri për krijimin e grupit. 3. Të miratohet grupi.
PËRPARËSI E lartë
REZULTATI I PRITSHËM Grupi i ngritur.
TREGUESIT Janë evidentuar personat për grupin.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Janar 2010
LIDHJE

Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15,16
VEPRIMI 13 Të instalohen kamera dhe pajisje teknike në kabinat e pikave të kalimit të kufirit për monitorimin e aktivitetit, të lidhura me monitorët në sallën operative në Drejtorinë e Përgjithshme.
VEPRIMTARIA 1. Përmirësim i mëtejshëm i vrojtimit Lidhet me: komunikimin, shkëmbim i informacionit dhe IT, objekti 1, veprimi 2
VEPRIMI 14 Të minimizohen veprimet e ligjshme financiare në PKK për të reduktuar në këtë mënyrë mundësinë për aktivitet të korruptuar.
VEPRIMTARIA 1. Të evidentohen fushat ku mund të minimizohen. 2. Të përgatiten propozimet. 3. Të miratohen propozimet.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Fushat ku mund të abuzohet, të minimizuara.
TREGUESIT Punonjësit e PKM nuk kryejnë veprime financiare.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III Kostot: Me fonde të PAMECA-s Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Janar 2010
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 15,16
VEPRIMI 15 Të bëhet analiza e aktivitetit të sistemit “TIMS” për aktivitetin e Policisë Kufitare
VEPRIMTARIA 1. Të identifikohen rastet e mosregjistrimit të shtetasve në kufi dhe mosmarrja e masave në rastet kur aktivizohet alarmi në sistemin TIMS. 2. Të identifikohen oficerët që lejojnë kalime të paligjshme. 3. Të bëhet krahasim i të dhënave të regjistruara me ato të vendeve të tjera. 4. Të bëhet intervistimi i personave të kthyer mbrapsht pasi refuzohen nga vendi pritës për të përcaktuar shkakun e kthimit dhe implikimin e punonjësve të PKM.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Aktiviteti i PKM monitorohet në vazhdimësi dhe me cilësi.
TREGUESIT Punonjësit e PKM veprojnë sipas rregulloreve. Rastet e abuzimeve janë ulur.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË Grupi i punës, MB, PSHSH/PKM, organizatat ndërkombëtare që asistojnë PSHSH, PAMECA III.

KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PKM/Të ndërmerret nga ekspertët afatgjatë të PAMECA III. Kostot: Me fonde të PAMECA-s. Përfitimet: Rritja e masave për luftimin e korrupsionit në radhët e PKM
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Janar 2010
LIDHJE Objekti 2/1, veprimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 16
Procedurat
Burimet njerëzore dhe trajnimi
OBJEKTIVI 1/1 Garantimi se Policia Kufitare dhe Migracionit është e aftë të organizojë dhe zhvillojë trajnime për personelin e saj në nivel qendror dhe lokal.
TREGUESIT Miratimi i kurrikulave të PKM-së. Ngritja e një mekanizmi për trajnim të specializuar mbi sistemin e sigurisë kufitare.
SITUATA AKTUALE Akademia e Policisë është përgjegjëse për rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin e të gjithë punonjësve të policisë. Aktualisht ka një strukturë zyrtare për trajnim të përgjithshëm mbi policimin kufitar në Qendrën e Formimit Policor. Duke parë nevojat e PKM-së dhe zhvillimet e saj në këto vite, si dhe duke vlerësuar resurset e saj, është në gjendje të bëjë trajnime të specializuara për të përsosur performancën dhe për të rritur efektivitetin e shërbimeve të saj. KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA I gjithë personeli i PKM-së do të marrë trajnim policor të specializuar në nivel qendror dhe lokal. Përveç kësaj, personeli i caktuar në PKM do të marrë trajnim të specializuar për policimin kufitar, në përputhje me kurrikulat e BE-së. Duhet të hartohen plane trajnimi për të nxitur bashkëpunimin brenda PKM-së, me PSHSH-në, si dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes PKM-së dhe agjencive të tjera që operojnë në kufi. Trajnimi për gjuhët e vendeve fqinje dhe asaj angleze është thelbësor.
VEPRIMET E PROPOZUARA 1. Të krijohet një mekanizëm për trajnimin bazë brenda Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe të bëhet evidentimi i trajnuesve në nivel qendror dhe lokal dhe i nevojave për trajnim. 2. Ngritja e kabineteve dhe kurrikulave për trajnim për kufirin detar.
PALET E INTERESUARA PSHSH, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti i Formimit Policor dhe Trajnimeve
VEPRIMI 1 Të krijohet një mekanizëm trajnimi brenda Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe të bëhet evidentimi i trajnuesve në nivel qendror dhe lokal dhe i nevojave për trajnim.
VEPRIMTARIA 1. Të evidentohen nevojat për trajnim të PKM. 2. Të identifikohen kandidaturat për trajnues. 3. Të bëhet testimi i kandidatëve për trajnues. 4. Të përgatiten temat për trajnim. 5. Të përgatiten kurrikulat. 6. Të përgatitet programi dhe plani i trajnimeve.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Një personel i PKM-së i mirëtrajnuar dhe profesional.
TREGUESIT Miratimi i mekanizmit të trajnimit, statusit të tij, programit dhe kurrikulave.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË PSHSH/ Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti i Formimit Policor dhe Trajnimeve
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Kostot: Përfitimet: PKM do të ketë një mekanizëm trajnimi në përputhje me standardet e BE-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Shtator 2009
LIDHJE: Objekti 1/1, veprimi 2
VEPRIMI 2 Ngritja e kabineteve dhe programeve për trajnim për kufirin detar.
VEPRIMTARITË 1. Grup pune i përbashkët i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin dhe partnerë ndërkombëtarë të bëjnë identifikimin e vendit për kabinetin. 2. Miratimi i kabinetit. 3. Ngritja e kabinetit. 4. Pajisja e kabinetit. 5. Përgatitja e programeve. 6. Zhvillimi i trajnimeve.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Kabineti i miratuar është ngritur, është kompletuar dhe zhvillohen trajnime.
TREGUESIT Nevojat për trajnim të PKM për detin të plotësuar.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË PSHSH/ Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti i Formimit Policor dhe i Trajnimeve
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Kostot: Përfitimet: Zhvillimi i trajnimeve të specializuara për detin.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR 2009-2010
LIDHJE Objekti 1/1, veprimi 1
Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit
OBJEKTIVI 2/1: Garantimi se pajisjet që do të pajiset Policia Kufitare dhe e Migracionit janë moderne dhe i përgjigjen stadi aktual të saj.
TREGUESIT Pajisjet e dhëna për pasaportat janë moderne dhe të përdorshme edhe për pasaportat biometrike dhe verifikimi i këtyre pasaportave bëhet në kohë reale. Sistemi i kamerave të vëzhgimit mundëson mbikëqyrje në kohë reale të aktivitetit në kufi. Automjetet verifikohen në moment nëpërmjet pajisjeve në përdorim.
SITUATA AKTUALE Aktualisht Policia Kufitare dhe Migracionit ka në përdorim pajisje për leximin e pasaportave aktuale.

Sistemi i lëshimit të pasaportave biometrike nuk gjeneron të dhënat në sistemin TIMS. Vetëm një pjesë e stacioneve të PKM ka kamera vëzhgimi. Regjistrimi i targave të automjeteve bëhet në mënyrë manuale. KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA: Pajisjet janë në përdorim të Policisë Kufitare dhe personeli është trajnuar për përdorimin e tyre. Koha e përpunimit të shtetasve dhe mjeteve ulet në mënyrë të ndjeshme. Procedurat kufitare lehtësohen.
VEPRIMET E PROPOZUARA 1. Të vendosen lexuesit optikë për pasaportat biometrike në PKK dhe të lidhet sistemi i pasaportave me sistemin TIMS. 2. Të zgjerohet sistemi i kamerave të vëzhgimit në PKK. 3. Të vendoset sistemi i leximit të targave të automjeteve në PKK.
PALET E INTERESUARA PSHSH, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e IT-së
VEPRIMI 1 Të vendosen lexuesit optikë për pasaportat biometrike në PKK dhe të lidhet sistemi i pasaportave me sistemin TIMS.
VEPRIMTARIA 1. Të identifikohen PKK ku do vendosen. 2. Të përgatiten specifikimet teknike të lexuesve optikë të pasaportave biometrike. 3. Të lidhen sistemi i pasaportave me sistemin TIMS. 4. Të përgatiten dokumentet e tenderit. 5. Të zhvillohet tenderi. 6. Të blihen pajisjet. 7. Të shpërndahen në PKK.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Personeli i PKK ka pajisjet për pasaportat biometrike dhe bën verifikimin në kohë reale të shtetasve.
TREGUESIT Pajisjet e dhëna për pasaportat janë moderne dhe të përdorshme edhe për pasaportat biometrike dhe verifikimi i këtyre pasaportave bëhet në kohë reale.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË PSHSH/ Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e IT-së
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Kostot: 60 000 euro Përfitimet: PKM do të këtë pajisje në përputhje me standardet e BE-së.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Shtator 2009
LIDHJE: Objektivi 2/1
VEPRIMI 2 Të zgjerohet sistemi i kamerave të vëzhgimit në PKK.
VEPRIMTARIA 1. Të përgatitet projekti i vendosjes së kamerave. 2. Të miratohet projekti. 3. Të kryhen procedurat e tenderimit. 4. Të zhvillohet tenderi.
5. Të sigurohen pajisjet. 6. Të vendosen pajisjet.

PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM PKK janë të lidhura në sistem <i>on line</i> nëpërmjet kamerave të vëzhgimit.
TREGUESIT Sistemi i kamerave të vëzhgimit mundëson mbikëqyrje në kohë reale të aktivitetit në kufi. Aktet korruptive të minimizuara.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË PSHSH/ Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtorja e IT-së
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Kostot: ICITAP Përfitimet: PKM do të këtë pajisje në përputhje me standardet e BE-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Shtator 2009
LIDHJE Objekti 2/1
VEPRIMI 3 Të vendoset sistemi i leximit të targave të automjeteve në PKK.
VEPRIMTARIA 1. Të bëhet studimi për vendosjen e lexuesve të targave. 2. Të identifikohen PKK ku do vendosen lexuesit e targave. 3. Të përgatiten specifikimet për lexuesit e targave. 4. Të përgatitet tenderimi. 5. Të blihen pajisjet 6. Të vendosen.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM PKK kryesore janë të pajisura me lexues të targave të automjeteve.
TREGUESIT Procedura më të thjeshtuara. Lehtësim hyrje-daljesh nëpërmjet kufirit të udhëtarëve dhe mjeteve. Monitorim më i mirë i qarkullimit në PKK.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
AKTORËT E PËRFSHIRË PSHSH/ Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, drejtorja e IT-së.
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Kostot: ICITAP Përfitimet: PKM do të këtë pajisje në përputhje me standardet e BE-së.
KOHËZGJATJA 1 vit
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Shtator 2009
LIDHJE Objekti 2/1
Infrastruktura dhe pajisjet
OBJEKTIVI 1/1 Sigurimi i kushteve të përshtatshme të personave që kthehen nga policitë e vendeve të tjera.

TREGUESIT Infrastrukturë e përshtatshme dhe në përputhje me standardet e BE-së.
SITUATA AKTUALE Infrastruktura aktuale e PKM-së nuk është e mjaftueshme dhe në përputhje me standardet e BE-së. KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Duhet të sigurohet infrastruktura e nevojshme për të kryer kontrollin e kufirit.
VEPRIMET E PROPOZUARA Të zhvillohet infrastruktura në përputhje me kërkesat e BE-së.
PALËT E INTERESUARA PSHSH, PKM
VEPRIM Të zhvillohet infrastruktura në përputhje me kërkesat e BE-së.
VEPRIMTARITË 1. Të krijohet grupi i punës për infrastrukturën dhe pajisjet. 2. Të vlerësohen nevojat e infrastrukturës aktuale në nivelin qendror, rajonal e vendor duke konsultuar studimet e kryera më parë. 3. Të përcaktohen përparësitë e të hartohen rekomandime. 4. Të hartohet plani i investimit dhe të dorëzohet për miratim. 5. Të vihet në zbatim plani.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Infrastrukturë në përputhje me standardet e kërkuara.
TREGUESIT Nevojat janë identifikuar. Plani i investimit i hartuar, miratuar dhe zbatuar.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/PKM, grupi i punës për infrastrukturën dhe pajisjet.
AKTORËT E PËRFSHIRË MB, MF, PSHSH/PKM, organizata ndërkombëtare që mbështesin PKM
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PSHSH Kostot: 7,7 milionë euro Përfitimet: PKM është e pajisur me infrastrukturën përkatëse
KOHËZGJATJA Në vazhdimësi
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Në vazhdimësi
LIDHJE
OBJEKTIVI 2/1: Përsosja e infrastrukturës në interes të realizimit të detyrës së Policisë Kufitare dhe Migracionit.
TREGUESIT: Infrastrukturë e përshtatshme dhe në përputhje me standardet e BE-së. Sallat operative duhet të monitorojë 24 orë aktivitetin në kufirin shtetëror. Pajisjet në përdorim të PKM duhet të jenë në gatishmëri të vazhdueshme. Njësia territoriale e lëvizshme e PKM ka ambientet e duhura për dislokim dhe përgatitje.
SITUATA AKTUALE Infrastruktura aktuale e PKM nuk është e mjaftueshme dhe në përputhje me standardet e BE-së. Policia kufitare nuk monitoron 24 orë aktivitetin në kufirin shtetëror. Mjetet në përdorim të Policisë Kufitare nuk rrihen në gjendje punë në kohë reale. KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Duhet të sigurohet infrastruktura e nevojshme për të kryer kontrollin e kufirit.
VEPRIMET E PROPOZUARA 1. Të krijohet salla operative e PKM në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. 2. Të ngrihet ofiçina e mjeteve të PKM-së

3. Të ridislokohet njësi e lëvizshme territoriale e PKM (Delta Force).
PALËT E INTERESUARA PSHSH, PKM
VEPRIMI 1 Të krijohet salla operative e PKM në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
VEPRIMTARITË 1. Të ngrihet grupi i punës për sallën operative në Departamentin e Kufirit. 2. Të përgatiten detyrat e personelit që do të punojë në sallën operative. 3. Të përzgjidhet personeli. 4. Të sigurohet ambienti dhe pajisjet. 5. Të fillojë funksionimi i sallës operative.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Infrastrukturë në përputhje me standardet e kërkuara.
TREGUESIT Kufiri monitorohet 24 orë. Shpejtësi reagimi nga shërbimet e PKM.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/PKM, grupi i punës për infrastrukturën dhe pajisjet.
AKTORËT E PËRFSHIRË MB, MF, PSHSH/PKM, organizata ndërkombëtare që mbështesin PKM
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PSHSH Kostot: ICITAP Përfitimet: PKM është e pajisur me infrastrukturën përkatëse.
KOHËZGJATJA Në vazhdimësi
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Në vazhdimësi
LIDHJE Objekti 2/1
VEPRIMI 2 Të ngrihet ofiçina e mjeteve të PKM-së
VEPRIMTARITË 1. Të ngrihet grupi i punës për ofiçinën e PKM-së departamentin e kufirit. 2. Të përcaktohet vendi ku do të dislokohet. 3. Të përzgjidhet personeli. 4. Të sigurohet ambienti dhe pajisjet. 5. Të fillojë funksionimi i ofiçinës.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Mjetet në përdorim të PKM mbahen në gatishmëri.
TREGUESIT Mjetet riparohen në kohë dhe shërbimet në kufi i kanë në gjendje punë.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHSH/PKM, grupi i punës për infrastrukturën dhe pajisjet.
AKTORËT E PËRFSHIRË MB, MF, PSHSH/PKM, organizata ndërkombëtare që mbështesin PKM
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PSHSH Kostot: 111 000 000 lekë Përfitimet: PKM është e pajisur me infrastrukturën përkatëse.

KOHËZGJATJA Në vazhdimësi
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Në vazhdimësi
LIDHJE Objekti 2/1, veprimi 3
VEPRIMI 2 Të ridisloketet njësia e lëvizshme territoriale e PKM (Delta Force).
VEPRIMTARIË 1. Të ngrihet grupi i punës për Delta Force të PKM Departamentin e Kufirit. 2. Të përcaktohet vendi ku do të disloketet. 3. Të sigurohen fondet. 4. Të përgatiten dokumentet e tenderit. 5. Të zhvillohet tenderi. 6. Të ndërtohet godina.
PËRPARËSI E mesme
REZULTATI I PRITSHËM Njësia territoriale e lëvizshme e PKM ka ambientet e duhura për dislokim dhe përgatitje.
TREGUESIT Përgatitja e Delta Force bëhet sipas parametrave dhe veprimtaria në operacione kufitare është sipas rekomandimeve.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE PSHS/PM, grupi i punës për infrastrukturën dhe pajisjet.
AKTORËT E PËRFSHIRË MB, MF, PSHS/PM, organizata ndërkombëtare që mbështesin PKM
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: PSHS Kostot: 111 000 000 lekë Përfitimet: PKM është e pajisur me infrastrukturën përkatëse.
KOHËZGJATJA Në vazhdimësi
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Në vazhdimësi
LIDHJE Objekti 2/1, veprimi 2
SHËRBIMI DOGANOR SHQIPTAR – BASHKËPUNIMI BRENDË SHËRBIMIT
Kuadri ligjor rregullator
Menaxhimi dhe organizimi
OBJEKTIVI 1/1 Garantimi se strukturat e Shërbimit Doganor Shqiptar janë të afta të kryejnë detyra në kuadër të sistemit të sigurisë kufitare.
TREGUESIT Strukturat e ngritura dhe efektive.
SITUATA AKTUALE Është krijuar struktura antitrafik që merret me armët konvencionale dhe të dëmtimit në masë, lëndë radioaktive dhe mallra të ndaluar, drogën, automjetet dhe veprat e artit dhe parandalimin e pastrimin e parave. KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Strukturat të jenë fleksibile dhe të afta të kryejnë detyrat e ngarkuara.
VEPRIMET E PROPOZUARA Të analizohet situata dhe të përgatitet e dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave për ndryshimet në strukturë.

PALËT E INTERESUARA Ministria e Financës/SHDSH
VEPRIM Të analizohet situata dhe të përgatitet e dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave për ndryshimet në strukturë.
VEPRIMTARITË 1. Të analizohen mangësitë. 2. Të përgatitet projekti. 3. Të dërgohet për miratim. 4. Implementimi i strukturës.
PËRPARËSI Kryesore
REZULTATI I PRITSHËM Efikasitet në luftën për parandalimin e trafikeve nëpërmjet kufirit.
TREGUESIT Struktura e miratuar dhe e vënë në zbatim.
AGJENCIA PËRGJEGJËSE Ministria e Financave/SHDSH
AKTORËT E PËRFSHIRË Ministria e Financave/SHDSH
KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA AKTORËT KRYESORË Agjencia: SHDSH Kostot: Përfitimet: Strukturë e profesionalizuar në fushën e luftës kundër trafikeve.
KOHËZGJATJA 6 muaj
LINJA KOHORE E PROPOZUAR Dhjetor 2008
LIDHJE
Procedurat
OBJEKTIVI 1/1 Garantimi se procedurat doganore do të përmirësohen dhe do të krijojnë lehtësira në kalimin kufitar.
TREGUESIT Procedurat standarde të brendshme të miratuara. Faza pilot ka filluar.
